REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 939/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komunës së Gllogocit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-20-6196-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **"ASFALTIMI I I RRUGËVE NË FSHATRAT TERSTENIK I, TERSTENIK II, SHTUTIC, VERBOVC, POLLUZHË, DOBROSHEC, ÇIKATOVË E VJETER, GLLANASELLË, GODANC, GRADICË DHE LIKOSHANË –Faza e dytë – Projekt dy vjeqarë."**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Vicianum, Arbëri

(Adresa)

Prishtinë — *(Vendi)*

10000 — *(Kodi postar)*

049 301049 — *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Berat Hasolli
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

vbinvest19@gmail.com
(Adresa elektronike)

13.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

VB INVEST SH.P.K. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Me datë 07.10.2020 në platformën eprokurimi është publikuar Njoftimi për kontratë lidhur me tenderin "ASFALTIMI I I RRUGËVE NË FSHATRAT TERSTENIK I, TERSTENIK II, SHTUTIC, VERBOVC, POLLUZHË, DOBROSHEC, ÇIKATOVË E VJETER, GLLANASELLË, GODANC, GRADICË DHE LIKOSHANË – Faza e dytë – Projekt dy vjeqarë", me Numër të Prokurimit 611-20-6196-5-2-1.
Me datë 30.10.2020 në platformën eprokurimi është publikuar Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit AK Komuna e Gllogocit shpërblen me kontratë N.T FER PETROLL dhe gjithashtu së bashku me këtë dokument është publikuar edhe Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, përmes të cilës GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA COMPANY SH.P.K, shpallet i pasuksesshëm.
Me datë 03.11.2020 GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K ka paraqitur Kërkesë për rishqyrtim ndaj Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit AK Komuna e Gllogocit shpërblen me kontratë N.T FER PETROLL dhe ndaj Letrës Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, përmes të cilës GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA COMPANY SH.P.K shpallet i pasuksesshëm.
Me datë 04.11.2020 AK Komuna e Gllogocit ka publikuar në platformën eprokurimi Vendimin për pezullimin e Njoftimit për Dhënie për projektin "ASFALTIMI I RRUGËVE NË FSHATRAT TERSTENIK I ,TERSTENIK II, SHTUTIC, VERBOVC, POLLUZHË,

DOBROSHEC, ÇIKATOVË E VJETER, GLLANASELLË, GODANC, GRADICË DHE LIKOSHANË –Faza e dytë –Projekt dy vjeqarë".
Me datë 10.11.2020 AK Komuna e Gllogocit ka publikuar në platformën eprokurimi Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.
Me datë 11.11.2020 AK Komuna e Gllogocit ka publikuar në platformën eprokurimi Vendimin lidhur me Kërkesën për rishqyrtim, më të cilin vendim thuhet se aprovohet pjesërisht Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K.
Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë 28.10.2020, ora 14:00.
Hapja e tenderëve është bërë me datë 28.10.2020, në ora 14:00, në Zyren e Prokurimit - Drenas.
Kriter për dhënien e kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Ne kemi marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve në kohën dhe vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe gjatë procesit të hapjes së tenderit çdo gjë ka shkuar në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] ***Jo*** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Me datë 03.11.2020 kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim pranë AK Komuna e Gllogocit, lidhur me Njoftimin mbi vendimin e AK Komuna e Gllogocit, për Aktivitetin e Prokurimit 611-20-6196-5-2-1, Njoftim me të cilin i është dhënë kontrata **N.T FER PETROLL**.
Lidhur me këtë kërkesë nuk kemi marrë asnjë përgjigjje brenda afatit 3 ditor, afat ky i cili përcaktohet me nenin 108/A, paragrafi 6, i Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin 05/L-068 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin 05/L-092 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, ku potencohet se **"Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të**

këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".
Gjithashtu e njëjta potencohet edhe me nenin 6, paragrafin 6.3 të "Rregullat për parashtrim të ankesave" i publikuar në webfaqen zyrtare të KRPP-së.
Pra, ne nuk kemi marrë asnjë njoftim, që afati do të shtyhet edhe për 3 ditë shtesë, ashtu siç e parashohin dispozitat e lartpërmendura.
Me datë 10.11.2020 AK Komuna e Gllogocit ka ngarkuar në platformën eprokurimi Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit shpërblehet me kontratë i njëjti OE që është shpërblyer edhe më herët dhe realisht përveç ndryshimit të datës, ky njoftim nuk ka asnjë dallim tjetër nga njoftimi i parë i AK.
Me datë 11.11.2020 AK Komuna e Gllogocit ka publikuar në platformën eprokurimi Vendimin lidhur me Kërkesën për rishqyrtim të **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K**, vendim me të cilin thuhet se aprovohet pjesërisht Kërkesa për rishqyrtim.
Vlen të ceket se ky vendim është marrë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin 05/L-068 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin 05/L-092 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe në kundërshtim me Rregullat për parashtrimin e ankesave, i publikuar nga webfaqen zyrtare të KRPP-së, sepse AK Komuna e Gllogocit nuk e ka respektuar afatin tre ditor, siç përcaktohet me ligj dhe gjithashtu nuk ka njoftuar se ky afat shtyhet edhe për tre ditë shtesë.
Gjithashtu, vendimi është në kundërshtim me dispozitat ligjore për shkak se fillimisht AK Komuna e Gllogocit ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe pas një dite ka publikuar Vendimin për Kërkesën për rishqyrtim.
Prandaj, GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K brenda afatit ligjor, paraqet këtë ankesë pranë OSHP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar procedurën e prokurimit publik dhe ka bërë shkelje të nenit 1, paragrafi 1, nenit 6, paragrafi 1, nenit 60, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 69, paragrafi 6, nën paragrafi 6.1, nenit 108/A, paragrafi 6 të Ligjit 04-L/042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës; ka bërë shkelje të pikës 26, paragrafit 26.1, nënparagrafit 2, paragrafit 26.2 dhe paragrafit 26.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, i publikuar në webfaqen zyrtare të KRPP-së; ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 6.3 të Rregullat për parashtrimin e ankesave, i publikuar në webfaqen zyrtare të KRPP-së, ka bërë shkelje të nenit 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, nenit 48, paragrafit 1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në Republikën e Kosovës.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 07.10.2020 në platformën eprokurimi është publikuar Njoftimi për kontratë lidhur me tenderin **"ASFALTIMI I I RRUGËVE NË FSHATRAT TERSTENIK I, TERSTENIK II, SHTUTIC, VERBOVC, POLLUZHË, DOBROSHEC, ÇIKATOVË E VJETER, GLLANASELLË, GODANC, GRADICË DHE LIKOSHANË –Faza e dytë –Projekt dy vjeqarë", me Numër të Prokurimit 611-20-6196-5-2-1.**
Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë me datë 28.10.2020, ora 14:00.
Hapja e tenderëve është bërë me datë 28.10.2020, ora 14:00.
Me datë 30.10.2020 në platformën eprokurimi është publikuar Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit AK Komuna e Gllogocit shpërblen me kontratë **N.T FER PETROLL** dhe gjithashtu së bashku me këtë dokument është publikuar edhe Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, përmes të cilës **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA COMPANY SH.P.K** shpallet i pasuksesshëm.
Me datë 02.11.2020 **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA COMPANY SH.P.K**, paraqesim Kërkesë për qasje në dokumente publike tek AK Komuna e Gllogocit, me anë të së cilës kërkojmë qasje në dokumentacionin e OE të shpallur fitues nga ana e AK dhe gjithashtu kërkojmë qasje në dokumentacionin e **OE IBRAHIM KURRUMELI B.I.**
Me datë 02.11.2020, AK Komuna e Gllogocit ka miratuar kërkesën për qasje në dokumente publike dhe ka kërkuar që të paraqitemi në AK Komuna e Gllogocit, me datë 02.11.2020 në ora 15:00.
Me datë 02.11.2020 jemi paraqitur në AK Komuna e Gllogocit, me ç'rast me USB kemi marrë dokumentacionin e kërkuar.
Me datë 03.11.2020 **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K** ndaj Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ndaj Letrës Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, për të cilën kërkesë kemi marrë përgjigjje jashtë afatit ligjor dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.
Kështu, **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K**, brenda afatit ligjor parashtron këtë ankesë ndaj të dyja këtyre akteve të AK Komuna e Gllogocit.
GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K, konsiderojmë se Vendimi i AK Komuna e Gllogocit është marrë në kundërshtim me procedurën e prokurimit publik dhe si i tillë është i pabazuar për arsyet si në vijim:

1. Gjatë analizimit të dosjes së OE të shpallur fitues, konkretisht **N.T FER PETROLL,** kemi vërejtur që i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional, pika 9.1 dhe 9.2 ku kërkohet **"Një inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me diplomë i caktuar me një vendim, CV".** OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk e ka prezantuar vendimin në lidhje me inxhinierin e kërkuar, andaj shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur dhe është dashur të shpallet si tenderues i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë. Mirëpo në këtë rast shihet qartë favorizimi që i është bërë OE të rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së, ku edhe pse është i papërgjegjshëm është rekomanduar për kontratë, ndërsa jemi diskriminuar ne si OE i përgjegjshëm.
2. Në këtë rast AK Komuna e Gllogocit ka bërë shkelje të nenit 1, paragrafit 1 të LPP-së, për

shkak se nuk ka arritur të siguroj realizimin e qëllimit të Ligjit, duke mos respektuar kriteret e vëna nga vet AK në dosjen e tenderit.

3. Pretendimi i njëjtë qëndron edhe për **OE IBRAHIM KURRUMELI B.I**, i cili në bazë të çmimit të ofertës është renditur si OE i dytë më i lirë, pas OE të shpallur fitues nga AK Komuna e Gllogocit.

   Pra, **OE IBRAHIM KURRUMELI B.I** nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit dhe njëjtë sikurse OE i rekomanduar për kontratë, sepse edhe këtij OE i mungon vendimi për inxhinierin e ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv, andaj shihet qartë se edhe ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

4. AK Komuna e Gllogocit ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 1 të LPP-së, për shkak se nuk ka arritur të siguroj efikasitet me rastin e vlerësimit të tenderëve të dorëzuar dhe në këtë formë ka shpallur fitues një ofertë që është dashur të shpallet i papërgjegjshme, për shkak se e njëjta nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara nga vet AK Komuna e Gllogocit.

5. AK Komuna e Gllogocit ka bërë shkelje të nenit 60, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 për shkak se AK Komuna e Gllogocit ka shpallur fitues një ofertë që nuk ka qenë e përgjegjshme, për shkak se nuk ka plotësuar një kriter që vet AK Komuna e Gllogocit e ka përcaktuar në dosjen e tenderit.

6. AK Komuna e Gllogocit ka vepruar në kundërshtim me nenin 69, paragrafi 1, sepse nuk ka respektuar kriterin që vet e ka vënë në dosjen e tenderit, kriter të cilin i'a mundëson saktësisht ky nen dhe me këtë rast ka shpallur fitues një tender që nuk i ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit.

7. AK Komuna e Gllogocit ka vepruar në kundërshtim me pikën 26, paragrafin 26.1, nënparagrafi 2 të **Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik**, sepse vet AK Komuna e Gllogocit ka përcaktuar atë kriter dhe në të njëjtën kohë, në momentin që një kriter i tillë nuk është realizuar nga OE i shpallur fitues dhe **OE IBRAHIM KURRUMELI B.I**, ofertat e tyre nuk i ka konsideruar si të papërgjegjshme, por njërin e ka shpallur fitues dhe tjetrin e ka konsideruar si të pasuksesshëm edhe pse është dashur që të dy këta OE ti shpall si të papërgjegjshëm, pasi që nuk i kanë plotësuar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë nga ana e AK-së.

8. AK Komuna e Gllogocit ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 26.2, i cili potencon se **"Kriteret e përshtatshmërisë" dhe "kërkesat minimale të kualifikimit" së bashku karakterizohen si "Kritere të Përzgjedhjes". Kriteret e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike".** Meqë oferta nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara me dosjen e tenderit, që konsiderohen kritere të përzgjedhjes, atëherë e njëjta është dashur të konsiderohet si e papërgjegjshme dhe ajo ofertë të mos shpallet fituese.

9. AK Komuna e Gllogocit ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 26.3, i cili saktësisht potencon se **"Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar. Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë".**

   Pra shihet qartë se AK-ja na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm duke na shpallur si tenderues të pasuksesshëm, ndërsa e ka favorizuar OE të rekomanduar për kontratë ku edhe pse është i papërgjegjshëm e ka rekomanduar për kontratë. Gjithashtu AK-ja e ka favorizuar edhe OE e dytë më të lirë duke e shpallur si të pasuksesshëm edhe pse ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

10. Gjithashtu, sa i përket inxhinierit të infrastrukturës që e ka kontraktuar me marrëveshje **OE N.T FER PETROLL** për këtë projekt, nënshkrimi i inxhinierit në marrëveshjen që e ka me **OE N.T FER PETROLL** është ndryshe dhe që vërehet qartë dallimi me dokumentacionin tjetër të bashkangjitur nga OE, që është Kontrata e punës, që i njëjti e ka

me **ENGRUP SH.P.K**. Në momentin që shikohen këo dy dokumente vërehet qartë se nënshkrimi i inxhinierit është ndryshe në marrëveshjen që e ka me OE të shpallur fitues dhe plotësisht nënshkrim tjetër ka i njëjti person tek kontrata e punës që e ka me **ENGRUP SH.P.K**.

Meqë këto nënshkrime të të njëjtit person janë plotësisht të ndryshëm nga njëri tjetri, ne dyshojmë në saktësinë e këtij dokumenti dhe kërkojmë nga ju që të detyroni AK që ti vërtetojë nënshkrimet e lartcekura AK që të marr parasysh këtë fakt.

11. Gjithashtu, OE i shpallur fitues është i papërgjegjshëm për faktin se e ka bashkangjitur planin dinamik ashtu siç kërkohet nga AK Komuna e Gllogocit, mirëpo ai plan dinamik është i pasaktë sepse me dosjen e tenderit potencohet që afati për përfundimin e punimeve është 60 ditë dhe gjithashtu në paramasën e çmimeve përcaktohet se 15 ditë pune janë në vitin 2020 dhe 45 ditë pune janë në vitin 2021, që do të thotë se në total janë 60 ditë. OE i shpallur fitues ka ngarkuar në platformën eprokurimi një plan dinamik për 90 ditë pune, që do të thotë se plani dinamik i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është konform kërkesave të dosjes së tenderit, kërkesë kjo që potencohet tek paramasa e këtij projekti. Pra përderisa OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar planin dinamik sipas kërkesës së dosjes së tenderit, atëherë është shumë i qartë fakti se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, andaj ne jemi të habitur se si ka mundur AK-ja të rekomandojë për kontratë një OE i cili nuk i ka përmbushur kërkesat e lartcekura.
12. Gjithashtu, vlen të ceket se sigurimi i dorëzuar nga OE i shpallur fitues nuk e ka nënshkrimin e personit të autorizuar për lëshimin e sigurimeve bankare dhe i njëjti si i tillë duhet të konsiderohet i pavlefshëm, me ç'rast oferta e OE duhet të shpallet e papërgjegjshme, për shkak se nuk i plotëson kriteret që përcaktohen me dosjen e tenderit.
13. AK Komuna e Gllogocit lidhur me Kërkesën për rishqyrtim që e ka paraqitur **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K**, ka marrë vendim jashtë afatit ligjor dhe në kundërshtim me nenin 108/A, paragrafin 6, të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin 05/L-068 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin 05/L-092 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, ku potencohet se **"Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë"**. Gjithashtu AK Komuna e Gllogocit ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 6.3 të **Rregullat për parashtrimin e ankesave**, i publikuar në webfaqen zyrtare të KRPP-së, i cili potencon saktësisht atë që e potencon edhe ligji i lartpërmendur.

    Kjo sepse AK Komuna e Gllogocit ka publikuar Vendimin lidhur me Kërkesën për rishqyrtim në platformën eprokurimi me datë 11.11.2020, e që realisht do të thotë se është publikuar në ditën e 8 (tetë), që nga dita e paraqitjes së Kërkesës tonë për rishqyrtim.
14. Gjithashtu, nëse lëshohemi në shqyrtimin përmbajtësor të Vendimit të AK Komuna e Gllogocit vërejmë që me atë vendim aprovohet pjesërisht Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga ne, mirëpo në të njëjtën kohë vërejmë që AK Komuna e Gllogocit ende pa e publikuar këtë Vendim, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin shpërblehet me kontratë i njëjti OE që është shpërblyer edhe para paraqitjes së Kërkesës për rishqyrtim. Poashtu, Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues bashkë me Letrat Standarde, nuk ka asnjë ndryshim me të njëjtin njoftim që AK e ka publikuar para paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim. I vetmi ndryshim është data e Njoftimit, ku njoftimi i parë e ka datën 30.10.2020, ndërsa njoftimi i dytë e ka datën 10.11.2020. Kjo nënkupton se AK Komuna e Gllogocit, nuk mund të thotë se është aprovuar Kërkesa jonë për rishqyrtim, për shkak se e njëjta nuk ka rezultuar me asnjë ndryshim, as në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, e as në Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Në këtë formë Vendimi i AK Komuna e Gllogocit është plotësisht i paqartë, kundërthënës, i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me nenin 48, paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në Republikën e Kosovës, sepse i njëjti në njërën anë thotë se është aprovuar pjesërisht Kërkesa për rishqyrtim dhe në anën tjetër nuk ka asnjë veprim apo arsyetim se në cilën pjesë është pranuar, e në cilën pjesë jo, sepse Njoftimi i publikuar është plotësisht i njëjtë me Njoftimin që është publikuar më herët, e që ndaj tij ne kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim. Në bazë të nenit 48, paragrafit 2 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në Republikën e Kosovës **"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"**, e që në këtë rast mund të themi se ky vendim është plotësisht i paarsyeshëm, që në të njëjtën kohë tregon se i mungon arsyetimi, mungesa e të cilit e bën vendimin e pavlefshëm, sepse në bazë të nenit 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 pjesa arsyetuese është element i detyrueshëm i aktit administrativ. Andaj mungesa e arsyetimit në këtë vendim, e bën të pavlefshëm të njëjtin.

15. Gjithashtu, AK Komuna e Gllogocit asesi nuk mund që fillimisht të ngarkoj Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, e pastaj Vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, ashtu siç ka bërë, sepse Njoftimin e ka publikuar me datë 10.11.2020, ndërsa Vendimin me datë 11.11.2020. këtu shihet qartë se si AK mundohet me çdo kusht të na eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.
Me këtë veprim të saj, AK-ja ka bërë shkelje të procedurës së prokurimit publik sepse ka marrë vendim, pa e shqyrtuar dhe pa vendosur lidhur me një kërkesë për rishqyrtim që ka qenë në procedurë. Në këtë rast AK Komuna e Gllogocit ka bërë shkelje të nenit 108/A, paragrafi 3 të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin 05/L-068 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin 05/L-092 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i cili potencon se **"Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar"**. AK Komuna e Gllogocit ka pezulluar procedurën me Vendimin e datës 04.11.2020, mirëpo veprimi i lartcekur tregon që AK nuk ka vepruar në pajtim me ligjin dhe as në pajtim me vendimin për pezullimin e procedurës.
16. Një fakt tjetër me rëndësi është që data që e përmban Vendimi i AK Komuna e Gllogocit, me të cilin thuhet se aprovohet pjesërisht Kërkesa jonë për rishqyrtim, është data 05.11.2020 e që realisht nuk qëndron, për shkak se nëse vendimi do të merrej me atë datë, atëherë është dashur të publikohet në të njëjtën datë dhe AK nuk do të përballej me mosrespektim të afateve ligjore. Vendimin e ka publikuar me datë 11.11.2020 që do të thotë se është jashtë afatit të përcaktuar me ligj. Pra këtu shihet qartë se si AK është munduar të na humb afatin për parashtrimin e ankesës në OSHP, duke u munduar të manipulojë me datat e lartcekura.
17. Kjo do të thotë që Vendimi i AK Komuna e Gllogocit është i pavlefshëm dhe i papranueshëm, sepse AK Komuna e Gllogocit ka dështuar që të nxjerrë një vendim të drejtë brenda afatit ligjor që e parasheh Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë dhe në bazë të këtyre fakteve, brenda afatit ligjor, **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K**, parashtrojmë këtë ankesë në OSHP.
18. Për këto arsye **GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA – COMPANY SH.P.K** i propozon OSHP-së, që pas pranimit të kësaj ankese dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, të marrë këtë:

AKTVENDIM

Aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e **VB INVEST SH.P.K** e parashtruar ndaj Njoftimit për vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 30.10.2020, me të cilin shpërblehet me

kontratë **OE N.T FER PETROLL** dhe Letrës Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm, me të **cilën GR OE VB INVEST SH.P.K & DT MINING SH.P.K & GËRLICA COMPANY SH.P.K** shpallet si e pasuksesshme, ashtu që në procedurën lidhur me tenderin **"ASFALTIMI I I RRUGËVE NË FSHATRAT TERSTENIK I ,TERSTENIK II, SHTUTIC, VERBOVC, POLLUZHË, DOBROSHEC, ÇIKATOVË E VJETER, GLLANASELLË, GODANC, GRADICË DHE LIKOSHANË –Faza e dytë –Projekt dy vjeqarë"** me Numër të Prokurimit **611-20-6196-5-2-1**, AK Komuna e Gllogocit të shpallë si të papërgjegjshme ofertën e **N.T FER PETROLL** dhe ofertën e **IBRAHIM KURRUMELI B.I** dhe të kaloj me procedurat sipas LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë se shkeljet e cekura më lart kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme materiale, kjo nga shkaku se kemi humbje materiale lidhur me koston që ka të bëjë me përgatitjen e ofertës. Kemi po ashtu humbje të konsiderueshme edhe sa i përket taksave të cilat jemi obliguar që t'i paguajmë për të siguruar garancionin bankar për sigurimin e tenderit, si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim. Gjithashtu kemi humbje edhe sa i përket taksës e cila duhet të paguhet në OSHP me rastin e dorëzimit të ankesës dhe shpenzimet lidhur me përpilimin e ankesës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*